



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 73/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.02.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Bolt shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr.REF-38106-12-14-2017, me objekt: “Blerje paisje dhe orendi për arredimin e pikave të reja të kujdesit ndaj klientit”, me fond limit 2,214,532 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 26.12.2017 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

**Ankimues:**

“Bolt” shpk  
Adresa: Njësia Tregtare Nr. 3, Blloku Gintash, Laprakë Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.  
Rruga “5 Maj”, pranë Medresesë Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15.12.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr.REF-38106-12-14-2017, me objekt: “*Blerje paisje dhe orendi për arredimin e pikave të reja të kujdesit ndaj klientit*”, me fond limit 2,214,532 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 26.12.2017 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 26.12.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

“HASANAGO” shpk	pa ofertë ekonomike	
“RO-AL” shpk	1.499.200 lekë	skualifikuar
“BOLT” shpk	1.576.500 lekë	skualifikuar
“ERZENI/SH” shpk	1.649.969 lekë	skualifikuar
“Erald” shpk	1.881.800 lekë	skualifikuar
“PAERA” shpk	1.905.200 lekë	skualifikuar
“SHAGA” shpk	1.932.840 lekë	kualifikuar
“Rafin Company” shpk	1.949.520 lekë	skualifikuar
“M. LEZHA” shpk	2.014.600 lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 05.01.2018, operatori ekonomik “Bolt” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

[...]

*“BOLT” sh.p.k. skualifikohet për arsyet e mëposhtëme:*

*Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.3 e cila sanksionin që ”Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikaten qe verteton qe sistemi i menaxhimit te cilësisë se prodhuesit, te mallrave objekt prokurimi, është sipas ISO 9001: 2015 ( e perkthyer dhe e noterizuar ne shqip).”, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë document që prodhuesit të jenë të paisur me certifikatë ISO 9001: 2015.II.5. Autoriteti kontraktor në datën 12.10.2017 me anë të shkresës nr.1805/4 datë 12.10.2017 i kthen përgjigje palës ankimese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik.*

II.3.1. Në datën 09.01.2018, operatori ekonomik “Bolt”shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimesi pretendon si më poshtë vijon:

[...]

*Nga njoftimi në portalin e APP-së më datë 05.01.2018 shikojmë renditjen dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesmarrës. Gjithashtu vëmë re dhe refuzimin e ofertës tonë (bashkëngjitur arsyet e refuzimit të hedhura në system)Sipas kvo-së arsyet e refuzimit janë:*

*Nuk plotësojmë kriteri e vendosur në pikën 2.3.3 e cila sanksionon që “Operatori ekonomik të paraqesë certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit të mallrave object i kësaj procedure prokurimi është sipas ISO: 9001:2015.*

*Përsa i përket kësaj arsye skualifikimi ne pretendojmë që KVO-ja pa e paragjykuar punën e tij në vlerësimin e ofertës, nuk ka pasur informacion e nevojshëm lidhje me këtë lloj dokumenti.*

*Ky document i kërkuar është ekuivalent me dokumentin që kemi hedhur në system dhe që është ISO 9001:2008.*

*Për këtë nga komunikimi që patëm dhe me zyrat e Akreditimit ISDQ Albania ju bëjmë me dije se gjatë periudhës tranzitore të konvertimit të Standartit nga ISO 9001:2008 në ISO 9001:2015 të gjitha certifikatat e lëshuara sipas Standartit ISO 9001:2008 janë të vlefshme deri më datën 15.09.2018 sipas udhëzimeve të International Organization for Standardization[...] Për informacione të mëtejshme*

*mund të kontaktoni gjithashtu dhe Entin Shtetëror të Republikës së Shqipërisë për Akreditimet.*

II.3.2. Në datën 16.01.2018, me shkresën nr536/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën e tij.

Autoriteti kontraktor arsyeton si më poshtë:

[...]

*OE "Bolt" spk pretendon se ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi certifikatë ISO 9001:2008 e cila është e vlefshme dhe ekuivalente me ISO 9001:2015 deri më datë 15.09.2018, kjo dhe sipas informacionit të dhënë nga zyrat e ICDQ Albania. Grupi i punës për shqyrtimin e ankesës bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KVO-ja vëren se OE "Bolt" shpk nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.3 pasi ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument që prodhuesit të jenë paisur me certifikatë ISO 9001:2015.[...]*

II.4. Në datën 23.01.2018 pala ankimuese "Bolt" sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 2519/1 prot., datë 31.01.2018 protokolluar me tonën me numër 98/2 prot., datë 01.02.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Bolt" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "Në DST është kërkuar "Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.3 e cila sanksionin që "Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën që verteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit, të mallrave objekt prokurimi, është sipas ISO 9001: 2015 ( e perkthyer dhe e noterizuar në shqip).", pasi ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument që prodhuesit të jenë të paisur me certifikatë ISO 9001: 2015.II.5. Autoriteti kontraktor në datën 12.10.2017 me anë të shkresës nr.1805/4 datë 12.10.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 7 "Kriteret Veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik" pika 2.3.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar: "

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit, të mallrave objekt prokurimi, është sipas ISO 9001: 2015 ( e perkthyer dhe e noterizuar ne shqip).

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Bolt” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*EN ISO 9001: 2008 (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), me objekt “Prodhim dhe tregtim mobiljesh. Tregtim të materialeve, artikujve industrial dhe produkteve për arredim”, me datë vlefshmërie deri më 14.09.2018 .*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1. 4. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”

III.1.5. Në nenin 30 të VKM nr. 914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. *Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor

është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO. Sa më sipër rezulton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur çertifikatat ISO 9001:2008, sipas standarteve ndërkombetare të lëshuar nga organizata "ICDQ", e cila është akredituar nga DA (Organizëm Akreditimi) si organizëm i certifikimit të sistemeve të manaxhimit të cilësive. Për këtë arsye, Komisioni e konsideron të përmbushur kërkesën e sipërcituar të autoritetit kontraktor

III.1.7. Nga verifikimet e kryera në ëeb-in zyrtar [http://www. http://www. <http://www.icdq.al>](http://www.icdq.al) të organizatës "ICDQ", K.P.P. sqaron se, çertifikata e mësipërme EN ISO 9001:2008 është e vlefshme siç dhe është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit objekt ankimi. Organizata Ndërkombetare e Standarteve (ISO) ka bërë axhornimin e dy standarteve ISO, përkatësisht ISO 9001:2008 me ISO 9001:2015. Organizmi i certifikimit "ICDQ", është i akredituar për këto dy standarte. Periudha tranzitore me Standartet e reja është deri me 14-09-2018. Pas kësaj date, standartet version 9001:2008 nuk do të jetë më e vlefshme.

III.1.8. Sa më sipër, nëse Autoriteti Kontraktor do të kishte dyshime të arsyeshme mbi vlefshmërinë e ISO-s të sipërcituar mund ti drejtohej vetë organit që i lëshon për konfirmimin e tyre. Sqarojmë autoritetin kontraktor se përcaktimi i kriterëve për kualifikim duhet të jetë në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit, si dhe duhet të jenë të argumentuara dhe justifikuara sipas specifikave përkatëse.

Pra sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Bolt" shpk për procedurën e prokurimit "Kërkesë për Propozim" me Nr.REF-38106-12-14-2017, me objekt: "Blerje pajisje dhe orëndi për arredimin e pikave të reja të kujdesit ndaj klientit", me fond limit 2,214,532 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 26.12.2017 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik "Bolt" shpk duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Bolt" shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 98 Protokolli; Datë 23.01.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Leonard Gremshi</b>	<b>Hektor Balluku</b>	<b>Kleves Janku</b>	<b>Odise Moçka</b>

**Kryetar**

**Evis Shurdha**

